

Anargjendët Kozma e Damian nga Azia. Oshënarëdëshmorët e rinj Jakovi (nga Vithkuqi i Korçës), Dionisi dhe Jakovi. Dëshmoret Kiriana dhe Juliana nga Kilikia



E premte, 1 nëntor 2024 – Shenjtori i ditës.

DITË KRESHME

Anargjendët Kozma e Damian nga Azia. Oshënarëdëshmorët e rinj Jakovi (nga Vithkuqi i Korçës), Dionisi dhe Jakovi. Dëshmoret Kiriana dhe Juliana nga Kilikia. Oshënare Theolipti.

- ANARGJENDËT KOZMA E DAMIAN, NGA AZIA -

Shenjtorët Kozma dhe Damian ishin nga Azia. Prindërit e tyre ishin një model i përkryer i bashkëshortëve të krishterë. Kur mamaja e tyre, Theodota, mbeti e ve, ia kushtoi të gjithë jetën edukimit të krishterë të fëmijëve, Kozmait dhe Damianit.

Të dy vëllezërit dalloheshin për zgjuarsinë e tyre dhe studiuuan shumë shkencë, veçanërisht shkencën e mjekësisë dhe përkushtimin human. Shëronin sëmundje të ndryshme pa marrë asnjë shpërblim dhe për këtë u quajtën anargjendë.

Të shumtë ishin ata të sëmurë të cilët, pasi gjenin shërim, dëshironin të falënderonin shenjtorët por ata nuk i pranonin shumë nderimet e njerëzve dhe u përgjigjeshin atyre duke përdorur fjalët e Shkrimit të Shenjtë: “Bekimi dhe lavdia, urtësia dhe falënderimi, nderimi, fuqia dhe forca janë tek Perëndia ynë në jetë të

jetëve”.

Kështu me përlësi anargjendët Kozma dhe Damian i shërbyen të tjerëve gjatë gjithë jetës së tyre. Ndërruan jetë në paqe dhe u varrosën në vendin e quajtur Ferema.

* * * * *

OSHËNARËDËSHMORËT E RINJ JAKOVI (nga Vithkuqi i Korçës), DIONISI DHE JAKOVI. Shën Jakovi lindi në një fshat të zonës së Vithkuqit të Korçës. Prindërit e tij quheshin Martin dhe Parashqevi. Mbas vdekjes së prindërve të tij ai punoi si bari dhe tufa e tij u rrit jashtëzakonisht shumë, duke shkaktuar kështu smirën dhe zilinë e vëllait të tij, ashtu si Abeli me Kainin. I verbuar nga zilia vëllai i tij sajoi një histori të rreme. Ai shkoi tek kadiu dhe i tha se Jakovi kishte gjetur një thesar të madh. Për të shpëtuar nga zilia e të vëllait dhe nga lakmia e kadiut, Jakovi u largua me shpejtësi nga fshati i tij dhe shkoi në Konstandinopojë. Atje ai filloi të merret me tregti, duke blerë dhe shitur bagëti.

Jakovi u pasurua shumë nga kjo tregti. Një ditë ai ndodhej si mik në shtëpinë e një turku të rangut të lartë, i cili e respektonte shumë krishtërimin. Turku i tregoi Jakovit se gruaja e tij kishte vuajtur shumë nga një sëmundje e rëndë mendore dhe ishte shëruar kur Patriku kishte vendosur mbi kokën e saj Ungjillin e shenjtë. Jakovit i bëri shumë përshtypje kjo dëshmi, e treguar nga një mysliman dhe u prek shumë në shpirt. Një dëshirë e zjarrtë iu ndez brenda dhe shkoi të takonte Patrikun. Në atë kohë Patrik ishte shën Nifoni – me origjinë arbërore dhe sipas traditës vëllamë i Gjergj Kastriotit. Mbase u rrëfye tek vetë Patriku, Jakovi e ndau gjithë pasurinë e tij tek të varfërit dhe pastaj, u nis për në Malin e Shenjtë, ku edhe filloi jetën murgërore.

Si murg, Jakovi praktikoi asketizëm të ashpër, duke ngrënë dhe duke fjetur shumë pak dhe duke kaluar pjesën më të madhe të ditës me punë dhe lutje. Ai e bëri zakon të fliste vetëm të shtunave dhe të dielave.

Duke kërkuar një qetësi më të madhe për t’u lutur, ai u largua nga manastiri dhe shkoi të jetonte në një vend të shkretë në brendësi të Malit të Shenjtë. Shpesh ngjitej në majën e malit Athos dhe e kalonte gjithë natën duke u lutur. Kështu murgu Jakov arriti një shkallë të lartë të jetës shpirtërore dhe pati shumë vegime qiellore. Njëherë gjatë lutjes, në vegim, iu shfaq një plak i shenjtë dhe i tha se ishte dëshira e Perëndisë të linte Malin e Shenjtë dhe të dëshmonte tek njerëzit që ishin në vështirësi me besimin.

Jakovi u largua nga Athosi i shoqëruar nga dy prej nxënësve të tij. Fillimisht ai vizitoi një qytet të quajtur Petra, pastaj shkoi në Meteora, ku qëndroi për një kohë të shkurtër dhe më pas u vendos në manastirin kushtuar Pararendësit në Dervekishtë, pranë Nafpaktos. Shumë njerëz filluan të vinin në manastir për të takuar shenjtorin, sepse fama e shenjtërisë së tij e kishte paraprirë. Kudo që ai

shkonte mblidhej një turmë e madhe. Jakovi predikoi shumë për të forcuar popullin në besim dhe bëri shërime dhe mrekulli të shumta. Fjalët e tij, të shoqëruara me mrekulli, kthyen shumë njerëz në rrugën e drejtë. Perëndia i kishte dhuruar atij dhuratën e profecisë dhe të gjitha profecitë që ai bëri u realizuan. Gjithashtu, ai kishte edhe dhuratën të dallonte mendimet e fshehta të çdo personi që takonte.

Por, jo të gjithë e pranuan këtë dhuratë që Perëndia kishte dërguar për shërim të shpirtrave. Ashtu siç ka ndodhur shpesh, drita urrehet nga errësira dhe në zemrat e papastra lind zilia kur flitet mirë për dikë. Kështu që zilia dhe smira u ndez në zemrën e disa murgjërve të tjerë, të cilët filluan të shpifin kundër Jakovit. Ata nxitën gjithashtu mitropolitin e Artës, Akakios, i cili edhe vetë ishte bërë xheloz nga veprimtaria e Jakovit. I errësuar nga zilia, ai informoi beun e Trikallasë, sikur Jakovi po kryente një aktivitet të fshehtë dhe po mblidhte njerëz rrotull tij për të filluar një kryengritje.

Ky lajm e tronditi beun dhe ai urdhëroi të arrestohet Jakovi dhe të sillet tek ai menjëherë. Por Jakovi e kishte parashikuar këtë dhe u përgatit me lutje për martirizimin që po e priste. Ushtarët erdhën dhe e arrestuan atë, sëbashku me dy nxënësit e tij, dhjakun Jakov dhe murgun Dionis. I çuan tek beu dhe ai e mori në pyetje Jakovin, herë me të mirë dhe herë me kërcënime. Pas dyzet ditësh, të lidhur me zinxhirë, i çuan para sulltan Selimit, i cili po qëndronte në Adrianopojë. Pas torturave të tmerrshme dhe përpjekjeve të dështuara të sulltanit për t'i detyruar të kthenin fenë, Jakovi dhe dy nxënësit e tij u vranë në 1 Nëntor të vitit 1519. (Disa sinaksarë të tjerë japin vitin 1520).

Lipsanet e tyre u blenë nga disa të krishterë të devotshëm dhe u varrosën në fshatin Arvanitohori, në tre varre të veçantë, pranë Adrianopojës. Lipsani i shën Jakovit u bë një burim mrekullish dhe shërimesh. Sot lipsanet e tij ndodhën në manastirin e shën Anastasisë Farmakolitria, në Selanik, ndërsa koka e tij në Mitropolinë e Kosturit. Një pjesë e vogël nga lipsani i tij që ruhet në Kostur iu dhurua Mitropolisë së Korçës me rastin e 500 vjetorit të martirizimit.

* * * * *

- DËSHMORET KIRIANA DHE JULIANA NGA KILIKIA -

Këto dy shenjtoresh u martirizuan në kohën e Dioklecianit (rreth vitit 305). Kiriana ishte nga Tarsi i Kilikisë dhe Juliana nga qyteti Roso i së njëjtës krahinë.

Me urdhër të Markianit, guvernatorit të Kilikisë, i kapën dhe kërkuan që ato t'u sakrifikonin idhujve. Por shenjtoret kundërshtuan me trimëri, prandaj e morën Kirianën, ia qethën kokën dhe vetullat dhe pastaj e hipën të zhveshur mbi gomar, duke e detyruar t'i binte katër herë përqark qytetit të Tarsit.

Nga pas e ndiqte një turmë fëmijësh, të cilët e godisnin me shkopinje dhe e përqeshnin, gjë që nxiste talljen e popullit dhe të ushtarëve. Por, në mënyrë të mistershme, e mbuluar nga veli i hirit, shenjtorja nuk ndjeu turp.

Pas kësaj e çuan në Roso, dhe e dogjën në zjarr bashkë me Julianën.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)